VENDIM
Nr. 217, datë 17.4.2014

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH PËR SHPENZIME KAPITALE, NDËRMJET PROGRAMEVE TË MIRATUARA NË BUXHETIN E VITIT 2014, PËR MINISTRINË E MJEDISIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr. 185/2013 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2014", me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve për shpenzime kapitale, ndërmjet programeve të miratuara në buxhetin e vitit 2014, për Ministrinë e Mjedisit, si më poshtë vijon:
a) Në programin "Mbrojtja e mjedisit" të shtohen fondet e mëposhtme:
i)Për projektin "Raportimi për konventat, harmonizimi i planit kombëtar të veprimit për të luftuar shkretëtirëzimin në Shqipëri dhe përgatitjen e raportit kombëtar, për kosto lokale, në vlerën 525 000 (pesëqind e njëzet e pesë mijë) lekë.
ii) Për projektin "Menaxhimi i integruar i ekosistemit të liqenit të Shkodrës", për kosto lokale, në vlerën 1 499 297 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.
iii) Për "Projekti i ozonit", për TVSH-në, në vlerën 1 720 000 (një milion e shtatëqind e njëzet mijë) lekë.
iv) Për projektin Adriatic IPA "*Building waste sustainability, new capacities for sustainable management*" BES-314, nga komuna e Bushatit, për TVSH-në, në vlerën 458 427 (katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind e njëzet e shtatë) lekë.
b) Në programin "Administrimi i pyjeve" të pakësohen fondet e mëposhtme:
i) Për kosto lokale, në projektin "Përmirësimi i administrimit të burimeve natyrore, SIDA TF 011576", në vlerën 2 024 297 (dy milionë e njëzet e katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.
ii) Për TVSH-në e prapambetur, projekti "Zhvillimi i burimeve natyrore", në vlerën 2 183 427 (dy milionë e njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e katërqind e njëzet e shtatë) lekë.
2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama